



Dialogu i BES-Net për polenizuesit, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural

Sarajevë, 18-20 tetor 2017

Axhenda

Nëpërmjet BES-Net, PNUD kontribuon në punën e Platformës Ndërqeveritare të Shërbimeve të Biodiversitetit dhe Ekosistemit (IPBES) për ngritjen e kapaciteteve. BES-Net mundëson dhe nxit dialogun ndërmjet tre komuniteteve, atij të shkencës, politikave dhe praktikës, për temat e vlerësimeve globale të IPBES. Dialogu i parë i BES-Net për polenizuesit, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural do të organizohet në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në datat 18-20 tetor 2017, do të drejtohet nga Ministria Federale e Mjedisit dhe Turizmit në Bosnjë-Hercegovinë si pika e kontaktit e IPBES, me mbështetjen e Fondit të Hapur Rajonal për Evropën Juglindore - Biodiversiteti (ORF-BD), i cili financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe zbatohet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.

Vlerësimi global i IPBES thekson rënien e numrit të polenizuesve dhe të shërbimeve të polenizimit në mbarë botën. Pjesëmarrësit në dialog do të vlerësojnë së bashku situatën aktuale në rajonin e Evropës Lindore, duke përfshirë ndikimin ekonomik dhe faktorët që nxisin rënien e numrit të polenizuesve në rajon, mënyrën se si ndikon kjo në biodiversitetin si edhe shërbimet që polenizuesit ofrojnë për bujqësinë, agro-biznesin dhe sigurinë ushqimore si edhe përfitimet e përbashkëta të rëndësishme nga menaxhimi i qëndrueshëm i polenizuesve dhe habitatit të tyre me qëllim që të arrihet një përshtatje e bazuar në ekosistem.

Objektivat e Dialogut janë:

1. Ndërgjegjësimi për gjetjet e vlerësimit global të IPBES për polenizuesit dhe prodhimin ushqimor;
2. Krijimi i një hapësire të përbashkët për vlerësimin e përbashkët të njohurive me rëndësi për rajonin në lidhje me polenizuesit, sigurinë ushqimore dhe zhvillimin rural dhe për identifikimin e përbashkët të politikave që ofrojnë zgjidhje të përshtatshme për rajonin; dhe
3. Përgatitja e një axhende të përbashkët për veprim.

Dita 1: E mërkurë 18 tetor

Ora	Aktiviteti
08:30 – 09:00	Regjistrimi
09:00 – 09:40	SEANCA E HAPJES
09:40 – 10:00	SEANCA PREZANTUESE: Objektivat e Dialogut
10:00 – 11:15	SEANCA TEMATIKE I: Vlerat e polenizimit dhe të polenizuesve - Një diskutim ndërveprues për vlerat e shumta të polenizuesve
11:15 – 11:30	Pushim për kafe shoqëruar me manaferra
11:30 – 12:30	SEANCA TEMATIKE II: Fjalimi kryesor. “A ka ndonjë problem dhe si mund ta dallojmë atë? Statusi dhe tendencat e polenizuesve, polenizimit dhe sigurisë ushqimore”. Prezantim i mesazhit kryesor nga eksperti global i IPBES dhe ekspertët rajonale për arsyet e shqetësimit global, rezultatet e vlerësimit të IPBES në nivel global dhe rajonal dhe implikimet për prodhimin ushqimor, zhvillimin rural dhe ekonominë bujqësore rajonale
12:30 – 14:00	Dreka
14:00 – 19:00	VIZITË NË TERREN: Vizitë në disa vende të përzgjedhura në afërsi të Sarajevës dhe diskutimi me profesionistët lokalë për çështje që kanë të bëjnë me polenizuesit e menaxhuar dhe ata të egër në afërsi të Sarajevës
19:00 –	Darka



Dita 2: E enjte 19 tetor	
Ora	Aktiviteti
09:00 – 09:15	Përmbledhje e ditës së parë
09:15 – 11:15	SEANCA TEMATIKE III: Paneli 1 “Faktorët rajonalë dhe kombëtarë që nxisin ndryshimin te polenizuesit dhe shërbimet e polenizimit”. Një panel i përbërë nga politikbërës dhe shkencëtarë nga rajoni, të cilët do të prezantojnë dhe do të diskutojnë për faktorët që nxisin ndryshimin në nivel kombëtar, do të gjejnë pikat e përbashkëta të kërcënimeve me të cilët përballen popullatat e bletëve në nivel rajonal dhe do të theksojnë çdo dallim mes situatave të vendeve në Evropën Lindore
11:15 – 11:45	Pushim për kafe shoqëruar me mjaltë
11:45 – 13:30	SEANCA TEMATIKE IV: Panairi tregtar i inovacionit - Idetë novatore për të trajtuar problemet dhe për të shfrytëzuar mundësitë e disponueshme
13:30 – 15:00	Dreka
15:00 – 18:00	SEANCA TEMATIKE V: Politikat dhe mënyrat e menaxhimit që mund të ofrojnë zgjidhje për të trajtuar rreziqet dhe mundësitë - Grup pune për identifikimin e politikave që mund të ofrojnë zgjidhje të përshtatura në nivel lokal
19:00 –	Darka

Dita 3: E premte 20 tetor	
Ora	Aktiviteti
08:30 – 09:45	SEANCA TEMATIKE IV dhe V: Paralel me mëngjesin e përfaqësuesve të nivelit të lartë, pjesëmarrësit do të përmbyllin prezantimet e punës së tyre duke treguar idetë novatore dhe veprimet në fushën e politikave dhe menaxhimit, duke qenë të gatshëm për t'i ndarë ato me të ftuarit e nivelit të lartë dhe me shtypin.
08:30 – 09:45	MËNGJES ME PËRFAQËSUES TË NIVELIT TË LARTË: Mesazhet kyçe nga vlerësimi global i IPBES dhe nga seancat e Trialogut diskutohen nga autoritete qeveritare, donatorë dhe partnerë të nivelit të lartë
09:45 – 10:15	Konferencë për shtyp
10:15 – 10:45	Shfaq dhe trego
10:45 – 13:00	SEANCA TEMATIKE V: Paneli 2 “Hapat përpara dhe ruajtja e ritmit”. Një panel i përbërë nga organizata mbështetëse kombëtare dhe ndërkombëtare do të bëjë komente dhe do të identifikojë mënyrat nëpërmjet të cilave idetë dhe veprimet nga Trialogu të mund të mbështeten nëpërmjet nismave të vazhdueshme në nivel kombëtar dhe rajonal
13:00 – 14:30	Dreka
14:30 – 16:00	SEANCA TEMATIKE V: Grup pune për identifikimin e politikave që mund të ofrojnë zgjidhje të përshtatura në nivel lokal lokal, të cilat do të përfshihen në Dokumentin e Rezultateve të Trialogut
16:00 – 16:15	Reflektime dhe vlerësime
16:15 – 16:45	SEANCA PËRMBYLLËSE